



**PROJEKTI I MIRËMBAJTJES DHE SIGURISË RRUGORE
BAZUAR NË PERFORMANCË DHE REZULTATE
RRMSP/CW/2015/3**



FINANCED BY :



EMPLOYER :



CONTRACTOR :



KONTRATA E MIRËMBAJTJES DHE SIGURISË RRUGORE ME PERFORMANCË BAZUAR NË REZULTATE

- Kontrata e mirëmbajtjes dhe sigurisë rrugore me performancë bazuar në rezultate për menaxhimin e mirëmbajtjes së rrugëve në vendin tonë është një koncept i ri, i hartuar për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e operacioneve të mirëmbajtjes rrugore.
- Ajo duhet të sigurojë që kushtet fizike të rrugës, në këtë kontratë, janë të përshtatshme për nevojat e përdoruesve të rrugës përgjatë periudhës së kontratës, e cila natyrisht është disavjeçare.
- Kjo tip kontrate zgjeron ndjeshëm rolin e sektorit privat, nga një realizues i thjeshtë i punëve të mirëmbajtjes në një menaxhues dhe ruajtës të aseteve rrugore dhe inventarit të tyre.

Çfarë Është Kontrata e Mirëmbajtjes së Rrugëve me Performancë Bazuar në Rezultate?

Kontratat e mirëmbajtjes së rrugëve me Performancë bazuar në Rezultate, përcaktojnë minimumin e kushteve të rrugës, urave dhe aseteve të tjera të trafikut, të cilat, duhet të arrihen nga kontraktori, së bashku me shërbime të tjera siç është mbledhja, regjistrimi dhe menaxhimi i të dhënave për inventarin dhe përgjigjja ndaj emergjencave (duke përfshirë edhe mirëmbajtjen dimërore).

Pagesat bazohen në efektivitetin me të cilin kontraktori arrin të përmbushë standardet e performancës së përcaktuar në kontratë dhe jo në volumin e punëve dhe shërbimeve të realizuara.

MIRËMBAJTJA RRUGORE ME PERFORMANCË BAZUAR NË REZULTATET MUND TË ARRIJË NJË NUMËR QËLLIMESH DUKE PËRFSHIRË:

- ▶ Reduktimin e kostove;
- ▶ Rritjen e efikasitetit;
- ▶ Përmirësimin e cilësisë;
- ▶ Siguron mbarëvajtjen e projektit;
- ▶ Nxiti risitë/inovacionin;
- ▶ Rrit menaxhimin e riskut/rreziqeve;
- ▶ Promovon ruajtjen dhe konservimin e aseteve;
- ▶ Identifikon dhe menaxhon më mirë problemet mjedisore dhe sociale.

ZONA E SHTRIRJES SË PROJEKTIT, KONTRATA C



Zona e projektit përfshin qarqet Fier, Elbasan dhe Korçe, si dhe zonat Kufitare Qafë-Thanë (kufiri në Maqedoni) dhe Kapshticë (kufiri në Greqi).

Përafërsisht gjatësia e rrugëve të kontratës është 419.42 km.

Nr.	Emri i rrugës	Gjatësia e rrugës (km)
1	Elbasan – Kapshticë	156.01 km
2	Tiranë - Elbasan	36.84 km
3	Durrës - Fier	44.00 km
4	Elbasan - Rrogozhinë	44.49 km
5	Qafë Thanë - Doganë	3.00 km
6	Pogradec - Tushemisht	5.90 km
7	Elbasan – Cërrik - Gramsh	41.20 km
8	Lushnje – Berat - Çorovodë	87.98 km
Gjatësia e rrugëve të Kontratës		419.42 km

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL (PMMS)

Qëllimi i PMMS:

- Identifikim dhe menaxhim i problemeve mjedisore dhe sociale
- Identifikim i masave zbutëse të nevojshme, për të zbatuar projektin në përputhje me kërkesat e Politikave Operacionale të Bankës Botërore dhe kërkesat e legjislacionit Shqiptar në fuqi.

PMMS:

- Jep një përshkrim të kushteve bazë mjedisore dhe sociale në rrugët e propozuar sipas skemës së këtij projekti.
- Jep një përmbledhje të ndikimeve të mundshme të shoqëruar me ndërhyrjet e propozuara për rehabilitime dhe përmirësime, përcakton masat menaxhuese të kërkuara për të zvogëluar çdo ndikim të mundshëm në mjedis.
- Detajon procedurat e menaxhimit social dhe mjedisor, proceset dhe masat zbutëse dhe monitoruese të kërkuara për aktivitete.
- Përshkruan masat që duhet të përdoren për shpërndarjen e informacionit për projektin dhe menaxhimin e ankesave.

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL (PMMS)

OBJEKTIVAT


- Përshkrimi i masave të nevojshme që duhet të zbatohen në lidhje me të gjitha efektet negative mjedisore dhe sociale që mund të gjenerohen nga aktivitetet e tij dhe si do t'i zbusë këto efekte.
- Përshkrimi i masave specifike shtesë që kërkohen për zbatimin e praktikave të mira lidhur me mirëmbajtjen, shëndetin dhe sigurinë në punë, kushtet e miratimit të përcaktuara nga Autoriteti Shqiptar i Planifikimit dhe Politikat e Procedurat Mbrojtëse të Bankës Botërore.
- Përcaktimi i procedurës së mbikëqyrjes dhe raportimit dhe përgjegjësitë për zbatimin e masave të përcaktuara nga PMMS.

PMMS – NDIKIMET POZITIVE TË PROJEKTIT

- Përmirësimi i Infrastrukturës së Rrugëve.
- Rritje e sigurisë së jetës për përdoruesit e rrugës.
- Punësim i fuqisë punëtore të aftë për punë në zonën e Projektit.
- Rritja e sigurisë së rrjetit rrugor duke sjellë rrugët në standardin e kërkuar.

Aktiviteti	Ndikimet e pritshme pozitive
Punime mirëmbajtje	• Sjellin rrugën drejt standardeve të kërkuara të performancës dhe plotësoni nivelin e shërbimit • Punësim. • Rritje e punësimit në zonat ku shtrihet projekti, staf teknik i kualifikuar dhe punëtorë të thjeshtë të pakualifikuar.
Ndriçimi	• Ruan jetën e komunitetit në aktivitetin e përditshëm në parametrat e duhur. • Rritet siguria e jetës në rrugë. • Zvogëlohen aksidentet.
Vendoje dhe përmirësim i sinjalistikës dhe tabelave rrugore	• Reduktohen aksidentet. • Rritet siguria e jetës në rrugë.
Punime rehabilitimi	• Arrihen standardet e performancës rrugore. • Punësimi. • Rritet siguria e jetës në rrjetin rrugor.

PMMS – NDIKIMET POZITIVE TË PROJEKTIT



PMMS – NDIKIMET POZITIVE TË PROJEKTIT



PMMS – NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS NGA ZHVILLIMI I PROJEKTIT DHE MASAT ZBUTËSE TË REKOMANDUARA

- Ndikime ne cilësinë e ajrit, emërtimi i pluhurave.
- Ndikime në ujë.
- Ndikime në tokë.
- Zhurmat dhe vibrimet.
- Gjenerimi i mbetjeve.
- Shëndeti dhe siguria në punë.
- Ndikime në natyrë dhe biodiversitet.
- Aksidentimi i kafshëve endacake në rrugë.
- Ndikime sociale.

PMMS –MASAT ZBUTËSE

❖ **Ndikime në cilësinë e ajrit, emetimit i pluhurave**

- ✓ Në stinën e verës aktivitete do të kryhen duke përdorur praktiken e spërkatjes me ujë.
- ✓ Nuk do të ketë djegie të mbeturinave në kantier.
- ✓ Nuk do të ketë lëvizje të shtuar dhe të panevojshme të automjeteve në kantier.
- ✓ Të gjitha materialet do të furnizohen/transportohen në një mënyrë që minimizon pluhurin - duke përfshirë kamionë të mbuluara
- ✓ Gjatë periudhave të motit të thatë, do të merren të gjitha masat e arsyeshme për të parandaluar shqetësimin për banorët, këmbësorët dhe përdoruesit e rrugës për shkak të pluhurit, ose rërës që del nga projekti si:
 - Eliminimi nëpërmjet përdorimit, lagies me anë të boteve të ujit.
 - Sigurimi i pajisjeve për pastrimin e gomave.
 - Mbulim i materialeve të ndërtimit.
 - Përdorimi i rrugëve të përcaktuara të ngarkesës.
- ✓ Servis i rregullt i automjeteve për të reduktuar emetimet e ndotësve në nivel të lejuar.
- ✓ Kamionët nuk do të mbingarkohen dhe shpejtësia e lëvizjes do të jetë e ulët.

PMMS –MASAT ZBUTËSE

❖ Për parandalimin dhe kontrollin e cilësisë së ujërave

- ✓ Mirëmbajtja e kanaleve, punime të kujdesshme në ura.
- ✓ Sigurimi që mbetjet dhe sidomos mbetjet e rrezikshme të mos interferojnë në burimet ujore sipërfaqësore apo nëntokësore.
- ✓ Mospërzierja e rrjetit të ujit të pijshëm nga ai i ujërave të zeza në përputhje me kërkesat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.
- ✓ Do të ndërtohen ambiente sanitare për punonjësit.
- ✓ Punimet duhet të jenë të veçuara nga rryma e mbetjeve.
- ✓ Duhet parandaluar erozioni nga rrjedhat ujore natyrore, ose rrjedha e stuhive.
- ✓ Në rast të derdhjes, uji i ndotur duhet të grumbullohet dhe të ruhet përkohësisht në kontenjerët me mbrojtje sekondare. Uji i ndotur duhet të shkojë në impiantin e trajtimit të ujit para se të shkarkohet.
- ✓ Ndalohet rreptësisht hedhja e mbetjeve në rrjedhat ujore.
- ✓ Ruajtja e materialeve potencialisht ndotëse dhe operacionet me karburantin nuk duhet të jenë afër rrjedhave ujore.

PMMS –MASAT ZBUTËSE

❖ Zhurmat dhe Vibrimet

- ✓ Të gjitha makineritë që punojnë në përdorim të përhershëm, do të fiken gjatë periudhave të ndërprerjes së punës ose do të vendosen të punojnë në minimum.
- ✓ Të gjitha automjetet dhe impiantet e përdorura gjatë operacioneve do të përshtaten aty ku është e përshtatshme me mekanizma të efektshëm për shuarjen e zhurmës dhe do të mbahen në gjendje të mirë pune.
- ✓ Të gjitha lëvizjet e pajisjeve të rënda do të menaxhohen për të minimizuar lëvizjet e automjeteve dhe emetimet e zhurmave.
- ✓ Të gjithë punonjësit do të përdorin pajisje mbrojtëse personale, si kufje, për t'u mbrojtur nga niveli i lartë i zhurmës.
- ✓ Punonjësit do të minimizojnë kohën e ekspozimit ndaj niveleve të larta të zhurmës.
- ✓ Mbi burimet/pajisjet që lëshojnë zhurmë: të nxitet përdorimi i pajisjeve e makinerive me nivel të ulët të zhurmave.
- ✓ Të fiken pajisjet dhe makineritë kur nuk janë në përdorim.
- ✓ Të punohet në orare të përshtatshme.

PMMS –MASAT ZBUTËSE

❖ Biodiversiteti

- ✓ Çdo pemë që duhet të pritej për sigurinë në rrugë do të pritet pas marrjes së lejes nga institucionet përkatëse lokale.
- ✓ Inspektim i vazhdueshëm. Monitorimi i grumbullimit dhe zonave të rehabilituara në mënyrë që të sigurohet pajtueshmëria me PMM dhe shmangia e erozionit.
- ✓ Shqetësimi i kafshëve dhe mbledhja e bimëve është rreptësisht e ndaluar.
- ✓ Djegia e mbetjeve, apo materialeve të ndryshme është rreptësisht e ndaluar.
- ✓ Në aktivitetet e parashikuara sipas këtij projekti, nuk do të përdoren herbicide (ose pesticide) për kontrollin e vegjetacionit.
- ✓ Për zonat e mbrojtura, leja për kryerjen e punimeve do të merret nga autoritete kompetente (Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura) dhe do të ketë këshillim të vazhdueshëm.
- ✓ Në zonat e mbrojtura dhe sensitive nuk do të përdoren herbicide për kontrollin e vegjetacionit.

PMMS –MASAT ZBUTESE

❖ Mbetjet

- ✓ Mbetjet urbane të njohura zakonisht si plehra, janë një lloj i mbetjeve që përbëhet nga sendet e përditshme që hidhen nga publiku.
- ✓ Llojet e mbeturinave do të mblidhen në mënyrë të diferencuar në kazanët përkatës, përgjatë rrugës. Koshat /kontejnerët do të jenë në dispozicion në sasi të mjaftueshme.
- ✓ Kompania do të përmbush kërkesat e hapësirës së posaçme për ruajtjen e mbeturinave dhe kontejnerëve të magazinimit.
- ✓ Regjistrimi i sasisë së mbeturinave (duke përfshirë llojet e mbeturinave, sasi të, kompanitë e transportit, destinacionet përfundimtare ose destinacionin e përpunimit, të licencuara nga kompanitë e transportit të angazhuar dhe objektet e përpunimit/depozitimit dhe dokumente të tjera të rëndësishme).
- ✓ Identifikimi i qartë për pajisje të ndryshme të depozitimit dhe ruajtjes së mbeturinave të rrezikshme.
- ✓ Këto mbeturina do të hiqen dhe depozitohen në zonën e miratuar të asgjësimit sipas një marrëveshjeje paraprake me autoritetet lokale që menaxhojnë këto zona të asgjësimit
- ✓ Do të mbahet regjistër mbi sasinë e mbeturinave të krijuara dhe të depozituara/në vendndodhjen e zonës së depozitimit.

PMMS –MASAT ZBUTËSE, MBETJET

Mbetjet, si ato urbane ashtu edhe ato inerte, hidhen në vendin e depozitimit të caktuar nga Bashkia.

Vegjetacioni, aty ku është e mundur ngrihet nëpërmjet makinerisë dhe lihet për t'u dekompozuar, ndërsa pjesa tjetër grumbullohet dhe transportohet në vendin e caktuar.



PMMS –MASAT ZBUTËSE

❖ Vrasja e kafshëve në rrugë

- ✓ Kontraktuesi është përgjegjës për mirëmbajtjen e autostradës dhe sigurinë për përdoruesit e rrugëve. Rrjedhimisht, edhe për mbledhjen e kafshëve të ngordhura nga rrugët. Kafshët e ngordhura duhet të hiqen brenda disa orëve nga marrja e një raporti apo njoftimi.
- ✓ Kafshët e vrara në rrugë do të groposen në një vend të përcaktuar me leje nga autoritete lokale.
- ✓ Kontraktori do të mbajë regjistrime për këto dhe do të shënojë vendin dhe koordinatat e vendit të groposjes.
- ✓ Vendndodhja e groposjes duhet te jetë:
 - i. distance (jo më afër se 500 m) nga zonat e banuara;
 - ii. në një vend ku nuk ka rrjedha ujore në afërsi të vendit të groposjes.

PMMS –Plani i Monitorimit dhe i Menaxhimit

- Zbatimi i PMMS do të raportohet rregullisht te Konsulenti Monitorues dhe ARRSH me anë të raportit të progresit mujor.
- Inspektimet në terren do të kryhen rregullisht / mujore nga specialisti mjedisor i kompanisë. Gjetjet e inspektimeve në terren do të paraqiten gjithashtu në raportin mujor të progresit.
- Çështjet specifike që lidhen me PMMS do të raportohen rregullisht si do të kërkohet nga ARRSH dhe Konsulenti Monitorues.

SHËNDETI DHE SIGURIA NË PUNË

Përdorimi i Pajisjeve Mbrojtëse Personale:
Syze, doreza, maska, jelekë fosforeshent,
këpucë, helmetë, etj.



Kryerja e trajnimeve mujore dhe
instruksioneve ditore.




INFORMIMI I KOMUNITETIT - MEKANIZIMI I ANKESAVE

Kontraktori do të zbatojë praktikat e mira të punës, të cilat përfshijnë angazhimin që të informojë komunitetin e zonës dhe publikun e ndikuar për:

- Çdo punë që do të çojë në devijim të përkohshëm të trafikut dhe ka të ngjarë të shkaktojë shqetësim për publikun e gjerë dhe përdoruesit e rrugës.
- Punimet apo aktivitete me mundësi për të shkaktuar dëmtime të pronës private do të bëhen njoftime në komunitete lokale.
- Nëse kërkohet punë urgjente, Kontraktuesi duhet të informojë bashkësinë lokale dhe autoritetin lokal për ndërhyrjen/mirëmbajtjen e planifikuar së paku tre (3) ditë përpara fillimit të punës.

MENAXHIMI I ANKESAVE



Ankesa mund të paraqitet në mënyrat vijuese:

- ❖ Duke komunikuar ankesën tek Autoriteti / Njësia Administrative ose Komuna (duke përdorur formularin zyrtar të ankesës, me letër / shënim ose gojarisht), i cili do të jetë përgjegjës për raportimin e çështjes Njësine e Menaxhimit të projektit (PMU);
- ❖ Duke dorëzuar ankesën drejtpërdrejt te Menaxheri i Projektit ose ARRSH (ose me gojë ose me anë të formularit të ankesës);
- ❖ Duke dorëzuar ankesën tek kontraktori i cili është përgjegjës për informimin e Menaxherit të Projektit dhe ARRSH-së.

MEKANIZIMI I ANKESAVE – MËNYRA E KONTAKTIT

NUMRI I GJELBER
0800 4343

EMAIL
rawafed.albania@gmail.com

Adrese Postare

RAWAFED AL-TOROK CONTRACTING
ESTABLISHMENT
Rr. Asim Vokshi,
Nd.14,H.4,Ap.4,Tirane,Albania



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

FINANCIIMI NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

PROJEKTI I MIRËMBAJTJES DHE SIGURISË RRUGORE BAZUAR NË REZULTATE
Lot 3 – Kontrata C – Rajoni Qendër/Jug-Lindje i Shqipërisë: Fier, Elbasan dhe Korçë
RRMSP/CW/2015/3

PUNËDHËNËSË: **AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**

VLERA E KONTRATËS (pa T.V.SD): **11,276,531 EURO**

KONTRAKTORI: **Rawafed Al-Torok Contracting Establishment**

FILLIMI I KONTRATËS: **13 MARS 2017**

PËRFUNDIMI I KONTRATËS: **31 DHJETOR 2021**

KONSULENTI: **JV IRD Engineering S.r.l – SINAS.p.a – SINECOS.p.a**

NUMRI I EMERJENCËS: **0 800 43 43**



PUNIME REHABILITUESE



PUNIME TË MIRËMBAJTJES RUTINË



PUNIME TË MIRËMBAJTJES RUTINË



PUNIME TE MIREMBAJTJES DIMERORE



PUNIME TË MIRËMBAJTJES DIMËRORE



RRETHRROTULLIMI I KORÇËS



Për të përmirësuar infrastrukturën dhe për të rritur sigurinë e përdoruesve të rrugëve është parashikuar të ndërtohet një rrethrrrotullim në hyrje të Korçës.

Drejtimit sipas këtij rrethrrrotullimi do jenë:

- KAPSHTICË-POGRADEÇ
- KAPSHTICË-KORÇË
- TIRANË-KAPSHTICË
- TIRANË-KORÇË
- KORÇË-KAPSHTICË
- KORÇË-TIRANË



RRETHRRROTULLIMI I KORÇËS



Pergatiti: Gledisa Vuksani Specialiste Mjedisi

RAWAFED AL-TOROK CONTRACTING ESTABLISHMENT

Str. Asim Vokshi, Nd.14, H.4, Ap.4, Tirane, Albania

rawafed.albania@gmail.com

FALEMINDERIT !